## Mesazhi i Kryetarit të Komunës

Fondi Shqiptar i Zhvillimit eshte nje nga organizatat, i cili si ne te gjithe vendin edhe ne Komunen tone te Xarres ne rrethin e Sarandes ka perpiluar dhe njekohesisht ka zbatuar disa projekte me se te domosdoshme te cilat sot jane me se konkrete ne funksionimin e tyre per mbare komunitetin .
Suksesi i ketyre investimeve e kane rrenjen ne bashkepunimin e vazhdueshem dhe interesin e perbashket midis Komunes Xarre ( e cila ka dhene kontributin e saj per realizimin e ketyre projekteve ) si dhe te Fondit Shqiptar te Zhvillimit .

Realizimi me sukses i ketyre projekteve beri ate qe :

- Te shtohet besimi tek komuniteti per nje bashkepunim me te ngushte me Fondin Shqiptar te Zhvillimit .
- Te gjenden forma dhe programe te reja per nje zhvillim sa me te shpejte per komunitetin .

Nje nga keto Programe eshte edhe projekti per hartimin e Planit te Zhvillimit Lokal. Ky program per mbare komunitetin tone ishte domethenes pasi:

- Filloi te ndergjegjesoje mbare komunitetin te marre pjese aktivisht per te percaktuar bashkarisht problemet si dhe rruget e zhvillimit te ketij komuniteti ne te gjitha fushat e jetes .
- Te degjohet mendimi i specialisteve per menyrat dhe format e zhvillimit lokal per cdo fushe ne kete zhvillim .
- Te percaktohet stragjedia e zhvillimit te komunitetit duke caktuar projektet afatgjate afatmesem , si dhe ato emergjente .
- Krijoj nje vizion te qarte tek gjithe pjesetaret e komunitetit per perfitimet qe i sjell komunitetit aplikimi i ketij programi .
- Per here te pare kane marre pjese masivisht ne percaktimin e problemeve me te domosdoshme per zhvillimin e ketij komuniteti .

Pra me pak fjale pergezojme F.SH.te Zhvillimit per mundesine e aplikimit te ketij programi P . ZH . L . per zhvillimin e komunitetit ne te gjitha fushat , si dhe jemi te hapur per nje bashkepunim sa me te frytshem per vazhdimin dhe permiresimin e ketyre programeve .
Si perfundim shikojme tek vetja si dhe tek ju si fond qe keto programe te vazhdojne duke u konkretizuar ne natyre , pra duke u pare dhe prekur me realitetin .

**KRYETARI**

**Dhimiter KOTE**

## Falenderime

Hartimi i këtij plani nuk do të ishte i mundur pa kontributin dhe dedikimin e Këshillit të Komunës dhe të anëtarëve të përmendur më poshtë:

## Këshilli i Komunës

## Komuna Xarrë:

### Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal ( PZHL )

Kryetari, (i zgjedhur nga grupi i PZHL) – Dhimitër Kote, Kryetari i Komunës
Anëtarë të Këshillit të Komunës – Gasper Mrruku,
Personel nga administrata e komunës – Sotir Deli, Kozma Mano, Pavlo Danga, Hanushe Sulo, Vasilika Tare, Proko Mavro, Besnik Kroji, Lefter Rubia, Vangjel Taho, Drita Avduli,
Banorë me profesione të ndryshme, nga zona të ndryshme të komunës - Kostandin Koço, Anastela Papa, Kristaq Tore, Sulo Veizi
përfaqësues nga fshatrat: Fatmir Sadiku, Zenel Rexhepi, Mihallaq Zervo, Petrit Doda, Spiro Cero,

### Grupi i Monitorim Vlerësim me Pjesëmarrje ( MVP):

Kryetarë – Agim Taka
Staf i komunës – Osman Xhaferri, Luiza Telushi,
Anëtarë Këshilli – Hysen Kakaci
Përfaqësues të komunitetit – Vera Mrruku, Anastasia Abeshi, Nexhmie Saliu
Numri total i anëtarëve në grupin e MVP: 7 anëtarë

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u bë i mundur edhe nga bashkëpunimi i frytshëm me Fondin e Zhvillimit Shqiptar (FZHSH). Si pjesë e programit të rritjes së kapaciteteve të qeverisjes lokale nën Projektin Punët e Komunitetit II (të financuar nga Banka Botërore), FZHSH përgatiti metodologjinë dhe një strukturë për planifikimin e zhvillimit lokal dhe përzgjodhi komunën tonë si komunë pilot për të testuar këtë metodologji. Gjatë punës së saj, FZHSH përfshiu Institutin Urban (Ëashington, DC) dhe Institutin e Kerkimeve Urbane (IKU) që të punonte me personelin e FZHSH në hartimin e metodologjisë dhe të monitoronte zbatimin. Në vazhdim të kësaj, FZHSH nënkontraktoi MixTecnic (Tirana) për të ofruar koordinimin, asistencën teknike dhe monitorimin e proçesit të hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal në Vithkuq.

## Hyrje

Në 2005 komuna e Xarrës u angazhua në proçesin e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal me qëllim që të përcaktonte një vizion të qartë për të ardhmen e komunës - dhe të caktonte hapat e veprimit për të arritur këtë vizion.

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u realizua në një proçes të hapur dhe transparent duke përfshirë këshillin e komunës, stafin e komunës, grupet e këshillimit dhe të ndjekjes, të krijuara në nivel komune dhe fshati si dhe anëtarë të tjerë të komunitetit në krijimin e një vizioni afatgjatë zhvillimi, objektivave strategjike si dhe hapat/projektet konkrete të cilat do të çojnë komunën e Xarrës drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, ky plan është pjesë strategjisë rajonale të zhvillimt për qarkun e Vlorës i cili filloi në 2004, duke inkorporuar objektivat afatgjatë deri më 2015. PZHL është një insiativë e re lokale, që nxit aftësitë planifikuese afatgjatë dhe prioritizimin e ndërhyrjeve.

***Pse Duhet të Hartojmë një Plan për Zhvillimin Lokal?***

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proçes që i jep mundësinë komunës sonë — dhe banorëve që ajo përfaqëson—të planifikojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Një Plan Zhvillimi Lokal jep informacion mbi drejtimin e veprimeve drejt zhvillimit të një komuniteti. PZHL është një hartë për tu ndjekur nga të zgjedhurit, personeli i komunës, dhe komuniteti në tërësi për ti dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. Planifikimi i Zhvillimit Lokal ka të bëjë me të menduarin, të vepruarin dhe të parishikuarin strategjik të veprimeve që duhet të ndërmarrim në mënyrë që të realizojmë qëllimet e dëshirueshme.

Një plan zhvillimi është efektiv kur ne e kuptojme se çfarë po bëjmë, kujt i shërben, dhe sa mirë i plotëson nevojat e komunitetit. Kur bëhet mirë, planifikimi i zhvillimit lokal ka pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Kjo garanton që ne po përdorim burimet më të mira të mundshme në planifikimin e së ardhmes ashtu si edhe krijon një forum të gjerë për pjesëmarrje të shoqërisë, përkushtim dhe rritje të ndjenjës së pronësisë.

Qëllimet strategjike dhe hapat e veprimit të shprehura në Planin e Zhvillimit Lokal nuk janë vetëm autoritet e qeverisjes vendore. Komuna nuk mund të bëjë vetë gjithçka, dhe as nuk mund t'i adresojë vetëm të gjitha problemet e komunitetit. Kështu që, në Planin e Zhvillimit Lokal është idea që i gjithë komuniteti ka një kontribut për të dhënë në arritjen e një komune të qëndrueshme. Angazhimi dhe veprimet e komunitetit, grupeve dhe të interesuareve të tjerë janë mjaft të rëndësishme në arritjen e suksesshme të Vizionit të Komunës, qëllimeve dhe veprimeve që janë themelore në Planet e Zhvillimit Lokal.

Një PZhL është efektiv kur në mënyrë rigoroze përdoret që të planifikojë shërbime dhe projekte, identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat fiskale, masë rezultatet e punës së qeverisë lokale, dhe ti komunikojë këto rezultate tek komuniteti. Ky është një proçes dhe dokument me anë të të cilit komuniteti mund të verë përpara përgjegjësisë udhëheqësit e tij në mënyrë që ti përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të tij. PZhL siguron një përdorim efektiv të burimeve specifike të komunave në mënyrë që të bëhet sa më e mundur arritja e objektivave.

## *Për Çfarë është Plani ynë i Zhvillimit Lokal?*

**Një vizion i Përbashkët**

Komuna jonë përballet me shumë sfida për zhvillim dhe burime të pakta për ti përballuar ato – por gjithashtu ne kemi shumë mundsëi. Detyra jonë është që t'i bashkojmë të gjitha burimet dhe komunitetin në një vizion të përbashkët për të cilin mund të mobilizojmë dhe të përdorim sa më mirë burimet tona njerëzorë, natyrore dhe financiare. Për të arritur këtë, proçesi ynë për hartimin e PZHL ftoi këshilltarët dhe komunitetin për "të pikturuar" të ardhmen tonë në 10 – 15 vitet e ardhshme. Rezultati i këtij aktiviteti ishte "Vizioni i Xarrës".

**Një plan për të Ardhmen Tonë**

E ardhmja jonë sigurisht që do të ndryshojë – dhe ne duhet të sigurohemi që ne jemi autorë të këtij ndryshim duke iu kundërvënë situatava rrethanore që përcaktojnë të ardhmen tonë. PZHL përmban qëllime dhe hapa veprimi të realizueshme, për të cilat ne jemi të sigurt që mund t'i arrijmë hap pas hapi në rrugën tonë për të përmbushur vizionin.

**Katër shtyllat**

Ne dëshironim të caktonim një rrjet të gjerë që të siguroheshim që të gjitha prioritetet e zhvillimit të përfshiheshin në PZHL. Kjo ishte arsyeja që e organizuam PZHL në bazë të katër fushave prioritare:

- Zhvillimi Ekonomik
- Zhvillimi Social
- Infrastruktura dhe Shërbimet Publike
- Qeverisja e Mirë

**Një Komunitet, Shumë Zëra**

Komuna jonë përbëhet nga shumë zëra – burra, gra, fëmijë, të vjetër, biznesmenë, fermerë e kështu me radhë. Ishte kritike për ne që të kuptonim shpesh sa të ngjashme po aq dhe të ndryshme ishin nevojat dhe pritshmëritë e këtyre grupeve. Proçesi i PZHL inkurajoi pjesëmarrjen e grave në grupet e këshillimit, dhe të gjithë përfaqësuesit e komunitetit u ftuan që të merrnin pjesë në hartimin e këtij plani.

**Komunikimi me Publikun**

Plani ynë i Zhvillimit Lokal është një bashkëbisedim me komunitetin. Ne morëm mendime dhe informacion nga komuniteti dhe shpresojmë që këto opinione janë të reflektuara në këto faqe. Ne kemi nevojë që të nxisim dialogun dhe opinionin e vazhdueshëm në mënyrë që të sigurohemi që po ndikojmë ashtu siç duhet tek komuniteti ynë.

**Një panoramë më e gjerë**

PZHL-ja jone ka të bëjë me të menduarin në terma afatgjatë në lidhje me nevojat e zhvillimit të Xarrës. Sidoqoftë, ne u kujdesëm që të merrnim parasysh edhe Strategjinë

Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Vlorës që të sighuroheshim që ishim në një linjë me Objektivat Rajonale dhe Kombëtare të Zhvillimit për Mijëvjeçarin (OZHM). Në këtë mënyrë PZHL-ja e Xarrës kontribon në arritjen e objektivave dhe prioriteteve kombëtare.

## *Kush u Përfshi në Hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal*

Për të pasur një proçes të hapur dhe transparent, në hartimin e planit për zhvillimin e komunës Xarrë, është synuar një pjesëmarrje e gjerë nëpërmjet krijimit të grupeve të këshillimit me bazë pjesëmarrjen e komunitetit. Pjesëmarrja e tyre ishte kyç për suksesin e hartimit dhe zbatimit të PZHL.

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (grupi PZhL): Ky grup është përgjegjës për nxitjen, udhëheqjen, këshillimin dhe mbikëqyrjen e hartimit të PZhL. Grupi i PZhL së Xarrës përfshiu 28 persona si : kryetari i komunës,dhe përfaqësues të këshillit, përfaqësues nga administrata e komunës, përfaqësues të fshatrave si dhe përfaqësues nga komuniteti.

Nënkomitetet e Fushave Prioritare: Këto grupe përfaqësojnë katër shtyllat kryesore (zhvillimi ekonomik, zhvillimi social, infrastruktura dhe shërbimet publike dhe qeverisja e mirë) dhe janë përgjegjëse në përcaktimin e hapave të veprimit/projektet konkrete për fushat prioritare dhe hartimin e prefizibiliteteve dhe fizibiliteteve. Këto grupe mund të ftojnë dhe specialistë të tjerë të jashtëm që të japin ekspertizën e tyre në detajimin e hapave të veprimit/projekteve konkrete.

Grupi i Monitorim-Vlerësimit me Pjesëmarrje (grupi MVP): Grupi i MVP-së ngarkohet të punojë ngushtë me grupin e PZhL dhe nënkomitetet për të përcaktuar kriteret, vlerësuar proçesin, caktuar matësat për realizimin e objektivave strategjike apo hapave të veprimit. Grupi monitoron edhe zbatimin e PZhL dhe raporton sukseset apo pengesat tek qeverisja vendore (komuna dhe këshilli i komunës) dhe komuniteti. Grupi i MVP përbëhet nga 7 persona që përfaqësojnë administratën e komunës dhe komunitetin.

***Figura 1. Diagrama që demonstron lidhjen midis grupeve të këshillimit***



## *Si e realizuam këtë proçes? Dhjetë Hapat për Hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal*

**1. Garantimi i angazhimit lokal.** Ky hap siguron që zyrtarët e qeverisjes vendore dhe personeli të njihen me qlëlimet e projektit dhe në të njëjtën kohë të angazhohen në këtë projekt. Në 5 qershor, u bë prezantimi i projektit në Këshillin e Komunës së Xarrës. Gjatë këtij takimi u zgjodhën 3 anëtarë të këshillit si pjesëmarrës të grupit të PZHL.



**2. Ofrimi i Asistencës.** Gjatë këtij hapi u orjentuan dhe trajnuan anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP për strukturën dhe metodologjine e PZHL/MVP. Trajnimi 2 ditor u organizua në 6-7 qershor dhe përfshiu 28 pjesëmarrës.

**3. Filimi i Punës.** Grupet e PZHL dhe MVP organizuan takime gjatë të cilave caktuan planin e aktiviteteve që do të ndiqnin, si dhe caktuan afatet kohore, rolet dhe përgjegjësitë për çdo anëtar të grupeve. Gjithashtu u organizua një fushatë komunikimi që përfshinte fletëpalosje me informacion për projektin dhe postera për panairet e ideve në fshatra.

**4. Mbledhja e informacionit.** Përpara se të mësojmë se ku po shkojmë ne duhet të dimë se ku jemi. Ky hap na lejon të bëjmë një vlerësim të situatës aktuale të komunës dhe të krijojmë një pamje më të plotë dhe të saktë të Komunës. Që këtë mund të fillojmë të mendojmë për të ardhmen e komunës. Kjo fazë ishte shumë e ngjeshur dhe kërkoi përkushtimin e grupit të PZHL si dhe të gjimnazistëve. Për shembull, anëtarë të grupit të PZHL plotësuan pyetësorin prej 14 faqesh për karakteristikat e komunës – cilat janë burimet tona natyrore/njerëzore, buxheti i komunës e kështu me radhë. Këto të dhëna u morën në zyrat e komunës apo në qark.

| Numri i Familjeve të Intervistuara | |
|---|---|
| Mursi | 55 |
| Shendelli | 15 |
| Shkallë | 18 |
| Vrinë | 38 |
| Xarrë | 45 |
| **Total** | **171** |

Në anketimin e familjeve, anketim gjatë të cilit u mor informacion nga komuniteti mbi shërbimet që ofron komuna. Anketimi u realizua në të pesë fshatrat e komunës. Familjet u zgjodhën në mënyrë të rastësishme në këto fshatra.

Dhe së fundi, u realizua analiza SËOC me këshillin e komunës në takimin e radhës. Kryetarët e fshatrave u përfshinë në këtë proçes dhe dhanë mendime shumë të vlefshme. Analiza SËOC – Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Sfidat – lejoi të zgjedhurit lokalë që të jepnin mendimet dhe opinionet e tyre për çfarë shkon mirë në komunë dhe çfarë nuk shkon siç duhet, si dhe të bënin sugjerime se si mund të përmirësoheshin fushat prioritare.

**5. Panairet e ideve në fshatra.** Për të marrë opinionin qytetar përveç anketimit u organizuan nga grupi i PZHL dhe Panairet e Ideve në Fshatra. Panairet e Ideve në fshatra u cilësuan si forume interaktive për të grumbulluar idetë dhe informacionet e banorëve dhe për ta përdorur këtë informacion në hartimin e PZHL. Panairet e ideve u

organizuan nga anëtarë të grupit lehtësues të PZHL dhe grupit të MVP, dhe kryetarët e fshatrave.



Panairet e ideve u organizuan në të pesë fshatrat nëpër vende të hapura, të përshtatshme dhe komode për pjesëmarrësit (Referou fig. 2). Në komunën e Xarrës morën pjesë nëpër këto panaire 236 pjesëmarrës në total nga të cilët 48 ishin gra dhe një numër i konsiderueshem të rinjsh të cilët dhanë një informacion shumë të vlefshëm.

**Figura 2: Konceptimi i Panairit të Ideve në Fshatra.**




**6. Sintetizimi i të Dhënave.** Me grumbullumin e të gjithë informacionit – profili i komunitetit, anketimi i familjeve, analiza SWOC me këshillin e komunës, dhe panairet e ideve në fshatra - u përgatit nga një paketë informacioni për rishikim për anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP. Duke pasur këtë informacion, grupi i PZHL së Xarrës:



a. Përcaktoi vizionin 10-15 vjeçar për komunën.
b. Zgjodhi anëtarët për nënkomitetet e fushave prioritare
c. Finalizoi objektivat strategjike për çdo fushë prioritare pas propozimeve të Nënkomiteteve të Fushave Prioritare
d. Votoi për Vizionin dhe Objektivat Strategjike përfundimtare

**7. Puna e Nënkomiteteve Të Fushave Proritare.** Ky hap përfshin planifikimin më në detaje të hapave të veprimit për çdo objektiv strategjik të fushave prioritare. Gjithashtu nënkomitetet u ngarkuan me detyrën e hartimit të prefizibiliteteve që të demonstrohej që hapat e veprimit dhe projektet ishin konkret, kuptimplotë dhe të realizueshme. Takimet e katër nënkomiteteve të fushave prioritare u kryen në një periudhë kohore prej 3 javësh. Gjatë kësaj kohe grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje punoi me përcaktimin e indikatorëve të cilët u zgjodhën në bazë të aktiviteteve/projekteve që ishin përcaktuar nga nënkomitetet e fushave prioritare. E gjithë kjo punë u prezantua në grupin e PZHL i cili diskutoi planet e veprimit për çdo fushë prioritare, matjen e performancës si dhe hapat në vazhdim. Grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje bëri dhe një raportim mbi ecurinë e proçesit si dhe sa mirë u arritën pritshmëritë e grupit të PZHL gjatë këtij proçesi.

**8. Ju Folët ne Ju Dëgjuam, a u Kuptuam Drejt?** Takime me komunitetin dhe rishikimi i Këshillit të Komunës: në momentin që grupi i PZHL ka përfunduar draftin e PZHL, ne e prezantojmë atë në komunitet në mënyrë që të sigurohemi që kjo PZHL i përgjigjet nevojave të komunitetit. Kryetarët e fshatrave luajnë rol kryesor në këtë detyrë.

**9. Integrimi me Proçesin e Buxhetit.** Qëllimi i PZHL-së është që ti lejojë komunitetet që të drejtojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Megjithatë, kjo nuk mund të kuptohet e ndarë nga proçesi i hartimit të buxhetit, pasi ky është momenti kur buxheti i limituar alokohet në ato zëra që ka më tepër nevojë komuniteti. Në hartimin e buxhetit, personeli i komunës paraqet zgjedhje konkrete dhe opsione për të zgjedhurit lokal se si mund të shpenzohen sa më efektivisht paratë e komunitetit. Duke pasur të dhenat dhe informacionin nga komuniteti, grupi i PZHL paraqet një panoramë për zgjidhjet e mundshme.

**10. Zbatimi dhe Monitorim-Vlerësimi i Vazhdueshëm.** PZHL ka nje plan të detajuar në të cilin janë përcaktuar edhe afatet kohore dhe përgjegjësitë. Grupi MVP është i ngarkuar me detyrën e monitorimit të progresit që bëhet për arritjen e rezultateve të matshme. Monitorimi do të bëhet rregullisht duke e lejuar grupin e PZHL-së, të zgjedhurit lokal, dhe personelin e komunës që të bëjnë ndryshime të nevojshme atëherë kur nevojitet. Progresi do të raportohet edhe në komunitet me mënyra të ndryshme – media lokale, takime me këshillin e komunës, dhe postera.

**Figura 3. Struktura e proçesit të PZHL**




## *Cili është Afati Kohor për Planin e Zhvillimit Lokal?*

PZHL përmban plane veprimesh afatshkurtër dhe afatgjatë. Vizioni përfshin një periudhë kohore prej 10-15 vjetësh. Sidoqoftë, për të qenë sa më realistike dhe që të sigurohemi që gjërat bëhen në mënyrën që duam ne, e kemi ngushtuar hapësirën e veprimit në 5 vjet. Çdo hap veprimi që paraqitet më poshtë ka një afat kohor për zbatim. Përputhja me këto afate kohore do të monitorohet nga grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje.

## Si ta Lexojmë Planin e Zhvillimit Lokal.

Publikimi i Planit të Zhvillimit Lokal përmban këto seksione:

- **Hyrjen** në të cilën shpjegohen qëllimi, pjesëmarrja dhe metodologjia.
- **Profili i komunitetit** që shpjegon në detaje situatën aktuale të komunës duke u bazuar në të dhënat objektive të grumbulluara nga Grupi i PZHL dhe që plotësohet me opinione në lidhje me anketën e familjeve të organizuar në Qershor 2005. Dhe aty ku nevojitet, janë shpjeguar dhe të dhëna nga Strategjia Rajonale e Zhvillimit për Qarkun e Vlorës me qëllim krahasimi.
- **Indikatorët e Performancës** për çdo fushë prioritare do të na lejojë që të monitorojmë progresin e bërë në arritjen e objektivave strategjike.
- **Të Qenurit në një Drejtim** me Strategjinë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Vlorës tregon që Xarra po kontribon në strategjitë e zhvillimit rajonal dhe kombëtar.

## Afatet kohore në të Cilat u Hartua Plani i Zhvillimit Lokal për Komunën e Vithkuqit.

| | |
|---|---|
| **Shkurt 05** | **Xarra u përzgjodh nga FZHSH si një nga 5 komunat pilote për të testuar metodologjinë e re të PZHL dhe MVP** |
| **Maj 05** | **FZHSH prezanton konceptin e PZHL tek Kryetari i Komunës dhe tek Administrata e Komunës** |
| **5 Qershor 05** | **Këshilli i Komunës voton pro për hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal** |
| **6-7 Qershor 05** | **Grupi i PZHL dhe MVP trajnohen në një trajnim dy ditor.** |
| **7 Korrik 05** | **Përfundon grumbullimi i të dhënave për profilin e komunitetit** |
| **15 Korrik 05** | **Përfundon grumbullimi i të dhënave nga anketimi i familjeve** |
| **17, 20 dhe 23 Qershor** | **Në fshatrat Vrinë, Xarrë dhe Shendelli organizohen e panairet e ideve** |
| **26 dhe 29 Qershor 05** | **Në fshatrat Mursi dhe Shkallë organizohen e panairet e ideve** |
| **Dhjetor 05** | **Organizohet analiza SËOC me Këshillin e Komunës dhe pjesëmarrjen e Kryetareve të fshatrave** |
| **16-17 Janar 06** | **Takohet grupi i PZHL dhe hartohet dhe aprovohet Vizioni final për Komunën si dhe caktohen anëtarët e Nënkomiteteve të Fushave Prioritare.** |

| | |
|---|---|
| **Janar 06** | **Nënkomitetet e Fushave prioritare hartojnë Objektivat strategjike** |
| **Shkurt 06** | **Grupi i PZHL finalizon Planin e Zhvillimit Lokal të propozuar** |

## Informacion i përgjithshëm për Komunën e Xarrës



*1. SHOQËRIA (Kapitali Social)*

**a. Komuniteti dhe Dinamika e tyre**

| Figura 1. Shpërndarja e Popullsisë | | | |
|---|---|---|---|
| **Fshati** | **Femra** | **Meshkuj** | **Gjithsej** |
| Xarrë | 1111 | 1199 | 2310 |
| Mursi | 1122 | 1196 | 2318 |
| Vrine | 592 | 602 | 1194 |
| Shkalle | 340 | 377 | 717 |
| Shendelli | 135 | 171 | 306 |
| **Komuna** | **3300** | **3545** | 6845 |

Numri i familjeve (viti 2005) në komunë është 1485 dhe duke u krahasuar me numrin e familjeve në vitin 2000 shihet se ka një rritje të numrit të familjeve gjatë pesë viteve të fundit. Ky është një fakt i rëndësishëm pasi në qoftë se krahasojmë me bashki/komuna të tjera zakonisht ka ulje të numrit të familjeve në pesë vitet e fundit. Pavaresisht se Xarra ka një lëvizje të popullsisë së saj kryesisht drejt Greqisë, në të njëjtën kohë ka lëvizje të popullsisë vendit nga zonat malore apo veriore (p.sh. Mirdita) në ato fushore apo bregdetare (drejt Xarrës). Nga 6845 banorë, 10.96 % janë pensionistë dhe në asistencë sociale janë 1.02 % e popullsisë. Sidoqoftë shkalla e papunesisë në komunë është e ulët për të mos thënë që mungon krahu i punës.

| Figura 2.Rënia e popullsisë në 2000-2005 | | |
|---|---|---|
| **Fshati** | **Nr. i familjeve në vite** | |
| | **2000** | **2005** |
| Xarrë | 500 | 460 |
| Mursi | 470 | 501 |
| Vrinë | 260 | 296 |
| Shkallë | 150 | 153 |
| Shendelli | 70 | 75 |
| **Komuna (Total)** | 1450 | 1485 |

Siç shihet dhe nga tabelat në të pesë fshatrat e komunës ndodhen më shumë se 300 banorë. Kjo situatë krijon një ambjent të përshtatshëm për një forcim të përgjithshëm të aktiviteteve ekonomike të këtyre fshatrave si dhe rrit kapacitetet e tyre për tregti.

## b. Arsimimi

Gjatë shtatë viteve të fundit i është kushtuar një vëmendje e veçantë objekteve arsimore në qarkun e Vlorës, ku janë ndërtuar apo rikonstruktuar shkollat. Në komunën e Xarrës objektet arsimore janë të përqëndruara në tre Fshatra: Mursi, Xarrë dhe Vrinë. Aktualisht Xarra numëron tre shkolla 9-vjeçare në të cilën mësojnë nxënës dhe ka 19 mësues dhe mungojnë shkollat e mesme. Gjimnazistët e Xarrës detyrohen të shkojnë ne Ksamil ose Konispol për të vazhduar gjimnazin. Në komunë ka dhe 2 kopshte fëmijësh në Mursi dhe Xarrë nën kujdesin e dy edukatorëve.

| Figura 3. Shpërndarja e shkollave, nxënësve dhe mësuesve në komunën e Xarrës | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Fshati** | **Shkolla 9-vjeçare** | **Nxënës** | **Mësues** | **Shkolla të mesme** | **Nxënës** | **Mësues** | **Kopshte** | **Fëmijë** | **Edukat** |
| Mursi | 1 | | 5 | | | | 1 | | 1 |
| Xarrë | 1 | | 7 | | | | 1 | | 1 |
| Vrinë | 1 | | 7 | | | | | | |
| **Komuna** | **3** | | **19** | **0** | | | **2** | | **2** |

Siç shihet dhe nga opinioni i komunitetit 47.3 % shprehen se janë ”shumë të pakënaqur” ose ”të pakënaqur” në lidhje me gjendjen e shkollave, ndërkohë që 72.5 % shprehen se janë të pakënaqur me gjendjen e kopshteve.



Figura4. Kenaqshmeria e Komunitetit me Gjendjen e Kopshteve dhe Shkollave ne Komune

Një problem tjetër është edhe mungesa e mjeteve dhe pajisjeve shkollore, veçanërisht e laboratorëve, duke shtuar dhe nivelin dhe metodat e mësimdhënies, kompetencën e mësuesve si dhe rishikimi i programit mësimor. Këtu nuk mund të flasim për numrin e kompjuterave në shkollë pasi ato nuk ekzistojnë fare.

Në panairet e ideve të organizuar në fshatra gjatë muajit Qershor 2005, komuniteti shprehu një interes të madh në drejtim të rikonstruksionit të objekteve arsimore e veçanërisht ndërtimin e një gjimnazi për nxënësit e Xarrës. Komuna e Xarrës i është përkushtuar punës në shtimin e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, si dhe në parandalimin e braktisjes së shkollës.

## c. Kultura dhe Koha e Lirë

Komuna e Xarres ka qenë një qendër e njohur dhe e rëndësishme e kulturës dhe me një trashëgimi të pasur kulturore. Ndodhet shumë afer me Butrintin dhe ka disa pika të vjetra arkeologjike që ia vlen të përmenden. Megjithatë jeta kulturore e komunitetit nuk është në nivelin e duhur. Komuniteti është i pakënaqur  dhe i mungojnë aktivitetet kulturore dhe artistike. Rreth 71% mendojnë se këto aktivitete mungojnë në komunë dhe i njëjti opinion është dhe për aktivitetet sportive, megjithëse ekziston një qendër sportive që operon në komunë.

**Figura 5. Kenaqshmeria e Komunitetit ne Lidhje me Aktivitetet Kulturore dhe Kohen e Lire**




| | Kultura | Sporti | Biblioteka | Rinia | Te Moshuarit | Trashegimia Kulturore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Sh. te kenaqur ose te kenaqur | 13% | 15.20% | 9.30% | 13.40% | 26.40% | 49.10% |
| I pakenaqur ose sh. te pakenaqur | 77.80% | 77.70% | 76.00% | 79.00% | 67.80% | 43.2% |

## d. Shërbimi Shëndetësor

Shërbimi shëndetësor në komunën e Xarrës realizohet nëpërmjet strukturave të shërbimit shëndetësor parësor. Sistemi shëndetësor në komunë përbëhet nga një qendër shëndetësore dhe 3 ambulanca ku punojnë mjek dhe disa infermierë dhe mami. Ashtu si në gjithë qarkun e Vlorës dhe në vendet me të ardhura të vogla, edhe në komunën e Xarrës sëmundjet infektive dhe përhapja e tyre janë një problem për komunitetin.  Kjo situatë e bën të domosdoshme riorganizimin e strukturave shëndetësore parësore në fshatra që kanë mungesë të këtij shërbimi në mënyrë që të plotësoj standartet rajonale për zonat rurale. Megjithëse fshatrat kryesore kanë shërbim ambulator me infermierë dhe një doktor që shkon një herë në javë në fshatra për vizitë, prapë ka nevojë për përmirësimin e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë një personel të kualifikuar. Gjithashtu këto ambulanca kanë dhe mungesë të pajisjeve të domosdoshme mjeksore dhe ilaçeve. Duke parë këto mangësi në shërbimin shëndetësor një pjesë e banorëve shkojnë dhe kurohen në Greqi (vetëm për fshatin Mursi pasi për pjesën tjetër këto mundësi janë të paarritshme)

**Figura 6. Kenaqshmeria e Komunitetit ne Lidhje me Qendrat Shendetsore dhe Higjenen**




| | Sh. i kenaqur | I kenaqur | I pakenaqur | Sh. i pakenaqur |
|---|---|---|---|---|
| Qendra Shendetsore | 11.70% | 45.60% | 13.50% | 21.60% |
| Higjena | 4.70% | 35.10% | 53.20% | 4.10% |

Në përgjithësi komuna vuan nga kushtet higjenike dhe kanalizimet. Pothuajse 57.3 % e komunitetit shpreh pakënaqësi për nivelin e higjenës në komunë në përgjithësi dhe kjo shifer rritet në 70.8 % kur komuniteti pyetet në veçanti për fshatrat. Ky problem është ngritur më shumë se një herë në Panairet e Ideve në të gjithë fshatrat e Xarrës.

Plani i Zhvillimit Lokal për Xarrën, ka përcaktuar disa objektiva dhe hapa veprimi konkret për përmirësimin e situatës shëndetësore dhe higjenës së komunitetit për të arritur standartet europiane.

## e. Asistenca Sociale

Ka dy kategori njerzish që përfitojne asistencë sociale: familjet pa të ardhura dhe familjet me të ardhura më të vogla se niveli i jetesës.
Komuna e Xarrës numëron 70 familje (1.02 %) që përfitojnë asistencë sociale. Sikurse shihet dhe në figurën 7 këto familje janë të shpërndara në 5 fshatra. Pjesa më e madhe e atyre që përfitojnë asistencë sociale ndodhen në Xarrë (28 banorë ose 5.6 % të numrit total të familjeve në këtë fshat) dhe Mursi (28 ose 5.7 % të numrit total të familjeve në këtë fshat)

Figura7. Numri i Familjeve qe Marrin Asistence Sociale




| | Xare | Mursi | Vrine | Shkalle | Shende |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Familjeve | 28 | 26 | 7 | 4 | 5 |

## f. Cilësia e Jetës

Me gjithë këto sfida në fushën e arsimit dhe shëndetit, në përgjithësi banorët e komunës së Xarrës janë të kënaqur me cilësinë e jetës, 72.5 % e tyre shprehen që janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me cilësinë e jetës dhe 92.4% besojnë se gjendja e komunës ka ndryshuar tre vitet e fundit.







## *2. Ekonomia*

## a. Situata e Përgjithshme

| Figura 11. Shpërndarja sipas Sektorëve të Punësimit e Banorëve të Xarres | | |
|---|---|---|
| | **Sektori Privat** | |
| **Lloji i aktivitetit** | **Të punësuar** | **Gra** |
| Bujqësi , gjueti silvikulture | 110 | 30 |
| Industri nxjëerrëse | 4 | 2 |
| Industria përpunuese | 9 | 4 |
| Ndërtim | 24 | |
| Tregtia, riparimi automob.dhe artikujve shtëpiak | 56 | 31 |
| Hotele dhe restorante | 5 | 3 |
| Transporti dhe telekomunikacioni | 10 | |
| **Totali** | **167** | **70** |

Burimet e konsiderueshme njerëzore e natyrore të komunës mundësojnë plotësisht një zhvillim të qëndrueshëm të komunës së Xarrës. Një pjesë e mirë e banorëve të arsimuar janë punësuar në sektorin publik.

Shkalla e papunësisë në këtë komunë është pothuajse zero. Sektori privat është kryesori për punësimin. Sikurse shihet nga figura 11, aktiviteti kryesor ekonomik është bujqësia dhe blegtoria. 110 persona, nga të cilët 30 gra janë të punësuar në këtë sektor.
Pjesa tjetër janë punësuar në degë të tjera si transporti, shërbimet tregtare, bare dhe restorante, shëndetësia dhe shërbime të tjera duke perfshirë bujqësinë dhe blegtorinë.
Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë lokale të Xarrës i jep prioritet disa fushave të zhvillimit ekonomik, është e justifikueshme që të kemi më shumë detaje.

## b. Blegtoria

Ky sektor, sikurse shihet dhe nga tabela e mësipërme, është sektori ekonomik kryesor për komunën dhe numëron 110 të punësuar. Blegtoria është sektor tërheqës dhe vazhdimisht në rritje për komunën. Kushtet natyrore të komunës favorizojne rritjen e deleve, dhive dhe gjedhëve. Numri i krerëve në përgjithësi ka ardhur duke u rritur në krahasim me vitet parardhëse. Ky zhvillim mund të shpjegohet me disa faktore si: kërkesa në rritje për produkte blegtorale, shpenzime jo të mëdha për zhvillimin e gjësë së gjallë, si dhe përshtatja e fermës së vogël për të rritur gjënë e gjallë. Figura

| Figura 12. Të Dhënat për Blegtorinë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Vitet** | Të imta | | Gjedhë | Shpendë |
| | Dele | Dhi | | |
| **2005** | 17666 | 794 | 740 | 4521 |

12 na jep një pamje të numrit të gjësë së gjallë në komunë. Megjithatë problem paraqet mungesa e kullotave për bagëtinë e cila po pengon dhe shtimin me ritme më të shpejta të gjësë së gjallë.

Megjithëse prodhohet shumë mish, pikat e përpunimit të mishit në komunë mungojnë dhe kushtet, në përgjithësi janë shumë të këqija. Ka tre pika për grumbullimin dhe përpunimin e qumështit, dhe momentalisht kjo pikë i plotëson nevojat e fermerëve në komunë, megjithatë në një perspektivë të largët me shtimin e numrit të bagëtive do duhet të shtohen edhe baxho moderne, kështu që komuniteti i Xarrës e ka përmendur këtë në panairet e ideve të zhvilluara në fshatra. Një nga problemet kryesore të zhvillimit të blegtorisë mund të përmendim përmirësimin racor, përmirësimin e strukturës së të ushqyerit, krijimi i kushteve të përshtatshme higjeno-sanitare, dhe rritja e numrit të krerëve në çdo fermë. Figura 13 na jep një ide më të qartë për produktet dhe sasinë e tyre që prodhohet në komunë.

| Figura 13. Prodhimtaria e Blegtorisë në Xarrë | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Delet | | | Dhitë | | Lopët | | Shpendët | |
| Mish | Qumësht | Lesh | Mish | Qumësht | Mish | Qumësht | Mish | Vezë |
| 113061 | 883300 | 21199 | 6430 | 111160 | 67932 | 1212110 | 4413 | 485 |

Xara ka risurse të mëdha për shtimin e numrit të krerëve në të imta dhe të gjedhëve. Fermerët duhen ndihmuar me programe posaçme për përmirësimin racor në të leshta dhe në gjedh duke u dhënë përparësi racave në drejtim të dyfishimit të prodhimit të qumështit dhe mishit. Është e nevojshme ndërhyrja me programe dhe projekte të veçanta për përmirësimin e kapacitetit të kullotave dhe për ndërtimin e ledheve për ujë për bagëtit e imta.

Nga drejtoria e pyjeve dhe kullotave duhet të bëhet një punë më e kujdesshme për shpërndarjen e kullotës që është në kufijtë administrative të komunës së Xarrës. Duhet që për fermerët që mbarështrojnë lopë për prodhim qumështi të futet mjelja mekanike.

## c. Bujqësia

Bujqësia dhe blegtoria përbëjnë sektorin kryesor të punësimit në komunën e Xarrës. Bujqësia në komunën e Xarrës ashtu si në të gjithë vendin ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë periudhës së tranzicionit. Qarku karakterizohet nga fermat e vogla për sa i takon sipërfaqes së tokës dhe fragmentizim të brëndshëm të fermave në 4-8 pjesë. Kjo pengon në mënyrë të konsiderueshme produktivitetin e tyre. Gjatë reformimit, krahas me tokën u shpërndanë dhe asete të tjera si traktorë, stalla etj. Toka bujqësore, me një sipërfaqe prej 2017 ha, është vendosur mbi një kryesisht mbi një terren fushor dhe kodrinor. Struktura e tokës në komunën e Xarrës tregohet ne figurën 14.

| Figura 14. Struktura e Tokes në Komunën e Xarrës | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Toke Bujqesore (ha) | | | | Pyje (ha) | Livadhe kullota (ha) Të tjera |
| Ara (ha) | Pemishte (ha) | Ullishte (ha) | Vreshta (ha) | | |
| 1857 | 60 | 50 | 50 | | 313 |



Ndryshimet në politikat e bujqësisë influencuan edhe prodhimin dhe orientimin e prodhimeve në komunë sikurse në gjithë qarkun e Vlorës. Karakteristike për këtë periudhë ishte mos prodhimi i disa produkteve që prodhoheshin shumë gjatë periudhës së komunizmit (gruri, thekra, agrumet, etj). Prodhimet kryesore të komunës tregohen në figurën 15. Peshen kryesore ne prodhimet bujqesore e ze shalqini i cili mbulon jo vetem nje pjese te madhe te tregut te Shqiperise por eksportohet dhe ne vende te tjera si Greqia, Kosova, Italia, Maqedonia, Kroacia dhe Mali i Zi.

| Figura 15. Prodhimet kryesore në Komunën e Xarrës | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Drithëra | | Produkte bujqësore | | | Fruta (t) | Vresht (t) |
| Grurë (t) | Misër (t) | Të ndryshme (t) | Patate (t) | Fasule (t) | | |
| 30 | 160 | 280 | 4 | 15 | 60 | 50 |

Zhvillimi aktual ekonomik i komunës përfshin disa drejtime e aspekte kryesore duke përmendur disa biznese të vegjël peshkimi dhe bletarie (kryesisht biznese familjare), ka tre pika të përpunimit të qumështit (baxho), si dhe një hotel dhe disa kafe dhe restorante të vegjël. Nxitja dhe përkrahja e këtyre bizneseve është përmendur edhe në Planin e Zhvillimit Lokal.

Pavarësisht nga gjithe këto mundësi për zhvillim, në qoftë se bëjmë fjalë për burimet natyrore dhe kapitalin Social, opinioni i komunitetit e reflekton më së miri gjendjen e punësimit. Kur janë pyetur për mundësitë e punësimit në komunë, 33.3 % e banorëve janë shprehur të pakënaqur.







## d. Telekomunikacioni dhe Teknologjia Informuese

Në komunën e Xarrës është shumë i përhapur komunikimi me rrjetin e lëvizshëm telefonik. Ky realizohet si shërbim në pesë fshatra të komunës nëpërmjet telefonisë celulare prej kompanive AMC e Vodafone si dhe atij grek. Shtrirja e telefonisë celulare nuk do të thotë se ka mënjanuar nevojën për përdorimin e telefonisë fikse. Sigurimi i familjeve rurale me lidhje telefonike fikse është një sfidë për të ardhmen.

Nuk mund të flasim për Teknologji informuese pasi në Xarrë nuk ka asnjë linjë interneti apo kompjutera.

Përsa i përket shërbimit postar në komunë ekziston vetëm një postë.

## e. Turizmi

Komuna e Xarrës ka burime natyrore të pasura e të shumllojshme. Ka disa pika arkeologjike, që kanë prejardhjen nga kohët ilire dhe paraqesin interes të madh kulturor dhe historik. Gjithashtu komuna e Xarrës është në kufi me Butrintin i cili ka vlera të mëdha historike dhe kulturore. Me rëndësi këtu janë dhe lagunat dhe gjinjtë me vlera turistike. Banorët e Xarrës janë të ndërgjegjshëm për këto burime dhe po përpiqen ti shfrytëzojne disa për të gjeneruar të ardhura. Në komunë ndodhet një hotel dhe një restorant, si dhe disa kafe të vogla. Turizmi familjar është në hapat e parë të zhvillimit.



Në përgjithësi mund të themi se komuna e Xarrës ka shumë burime natyrore dhe njerëzore. Njerëzit janë relativisht të arsimuar dhe me kapacitete. Natyra është e favorshme për blegtorinë dhe disa produkte bujqësore. Klima, natyra e bukur, burimet ujore, dhe vlerat unike kulturore dhe historike po inkurajojnë disi zhvillimin e turizmit familjar. Po për të arritur atje, duhet të përmirësohen dhe shumë gjëra të tjera.

## *3. MJEDISI DHE INFRASTRUKTURA*

## a. Pozita Gjeografike e Komunës



| Figura 17. Shpërndarja e Tokës sipas Fshatrave | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Fshati** | **Toke Bujqësore (ha)** | | | | **Livadhe kullota (ha)** |
| | **Ara (ha)** | **Pemishte (ha)** | **Ullishte (ha)** | **Vreshta (ha)** | |
| Mursi | 627 | | 50 | 40 | 164 |
| Xarrë | 666 | 50 | | 10 | 49 |
| Vrinë | 350 | | | | |
| Shkallë | 214 | 10 | | | 100 |
| Shendelli | | | | | |
| **KOMUNA** | **1857** | **60** | **50** | **50** | **313** |

Komuna e Xarrës është njësi administrative e qarkut të Vlorës. Popullsia arrin në 6845 banorë e shpërndarë në 5 fshatra: Xarrë, Mursi, Shkallë, Shendelli dhe Vrinë. Komuna ka 2,330 ha tokë të shpërndarë në këto 5 fshatra.

## b. Burimet Natyrore

Komuna e Xarrës ka burime të pasura dhe të shumëllojshme natyrore. Ajo ofron një pejsazh të bukur kryesisht fushor, me ujra sipërfaqësore e nëntokësore të bollshme e cilësore, mes tyre edhe laguna e gjire, me masive shkembore që i japin variacion në formë e në ngjyrë këtij pejsazhi. Kjo natyrë të bën optimist për mundësitë e zhvillimit të kësaj komune. Xarra ka sipërfaqe të konsiderueshme me kushte të përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor (në Mile) dhe atij detar.

## c. Sistemi Rrugor

Rrjeti rrugor dhe transporti është një nga instrumentat që u nevojitet njerëzve në prodhimin e mallrave dhe shërbimet.
Nga pikëpamja administrative rrjeti rrugor ka dy pronarë: drejtoria e rrjetit rrugor rural dhe komuna. Duke e konsideruar faktor të rëndësishëm rrjetin rrugor vitet e fundit janë bërë investime të rëndësishme në rrjetin rrugor rural duke

| Figura 19. Rrjeti Rrugor në Xarrë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rrugë rurale rajonale (km)** | | **Rrugë rurale komunale (km)** | | **Rrugë Lagje (km)** | |
| Asfalt. | Paasfalt. | Asfalt. | Paasfalt. | Asfalt. | Paasfalt. |
| - | - | **4.1** | - | - | - |

Figura 20. Kenaqshmeria e Banoreve me Gjendjen e Rrugeve



përdorur fondet e buxhetit të shtetit, donatorë të ndryshëm si dhe nga vetë komuna. Gjithë komuna lidhet me qytetin e Sarandës mes rrugës që e pret atë mes përmes prej Butrintit dhe vazhdon drejt Konispolit. Segmenti që përshkon komunën tonë është i asfaltuar në masën 80%. Rrugët brenda fshatrave janë të kalldreëta por me cilësi që lënë për të dëshiruar. Megjithatë nëse shohim reagimin e komunitetit për rrugët e komunës në përgjithësi rezulton që 70.10% e komunitetit shprehen „shumë të kënaqur“ ose „të kënaqur“ me cilësinë e rrugëve. Sipas anketimit të realizuar, banorët e komunës Xarrë japin vlerësimin e paraqitur me grafik për gjendjen e rrugëve.



## d. Furnizimi me Energji Elektrike

Furnizimi me energji elektrike realizohet nga sistemi qendror i vendit.

**Figura 21. Rrjeti i Furnizimit me Energji Elektrike në Xarre**

| Rrjeti Kryesor TL (km) | Rrjeti kabllor I TU (km) | Numri i Kabinave Elektrike | Numri i Transfor-matoreve | Përfitues (familje) |
|---|---|---|---|---|
| **27** | | **7** | **7** | **1485** |

## e. Furnizimi me Ujë të Pijshëm

Për furnizimin me ujë të pijshëm në komunë përdoren kryesisht dy mënyra: me ujësjellës dhe çezma sipërfaqësore. Furnizimi me ujë të pijshëm i popullsisë së komunës realizohet prej 5 ujësjellësash, 18.5 km linjë e jashtme dhe 22 km rrjet shpërndarës. Nga stacioni i pompimit me ngritje mekanike që ndodhet në Mursi marrin ujë me linja fshatrat Mursi, Xarre, Shendelli dhe Vrinë. Ndodhet dhe një stacion pompimi tjetër në Shkallë që furnizon me ujë fshatin Shkallë. Sikurse shihet dhe nga opinioni qytetar, 94.7% e popullsisë shprehen që janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me sasinë e ujit të pijshëm. Kjo është një shifër që duhet konsideruar pasi në vitet e fundit janë bërë shumë ndërhyrje dhe sistemime në sistemin e ujit të pijshëm. Megjithatë ka akoma punë për të bërë në disa ujësjellësa.



| Figura 23. Rrjeti i Furnizimit me Ujë të Pijshëm | | |
|---|---|---|
| **Fshati** | **Gjatësia e rrjetit shpërndarës (km)** | **Gjatësia e rrjetit të jashtëm (km)** |
| Xarrë | 8 | 5 |
| Mursi | 7 | 2 |
| Vrinë | 2 | 9 |
| Shkallë | 3 | 1.5 |
| Shendelli | 2 | 1 |

## f. Kanalizimi i Ujrave të Zeza dhe të Bardha

Kanalizimi i ujrave të zeza dhe të bardha është një element i infrastrukturës që ka filluar të vlerësohet sidomos në vitet e fundit. Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujrave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin. Kanalizimi i ujrave të zeza është i pjesshëm. Për godinat ish shtetërore ka kanalizime të tilla. Shtëpitë private punojnë me gropa personale për çdo shtëpi. Rreth 3.9 km rrjet kryesor u ofrojnë shërbim jo të plotë 340 familjeve të fshatrave të komunës. Aktualisht kjo përbën dhe një problem

**Figura 24. Kenaqshmeria e Banoreve me Gjendjen e Kanalizimit te Ujrave te Zeza**




për komunën.  Sikurse shihet dhe nga opinioni qytetar i dalë nga anketimi i bërë në pranverë të 2005, 70.70 % e popullsisë shprehen se janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me kanalizimet e ujrave të zeza.

## *4. QEVERISJA E KOMUNËS*

## a. Organika e Komunës Xarrë

Në organikën e vet administrata e Komunës së Xarrës numëron  11  punonjës. Me poshtë janë të ilustruar dhe të ndarë sipas departamenteve:

**Figura 25. Organika e Komunës së Xarres**



## b. Buxheti i Komunës

Buxheti i komunës për vitin 2005 është 38,531,000 lekë,. Kjo sasi sikurse vihet re dhe në figurën 26 është shtuar shumë pak në tre vitet e fundit. Pjesa më e madhe e të ardhurave vjen nga fondi i kushtëzuar i qeverisë dhe buxheti i shtetit.

Kontributi i komunës në krijimin e të ardhurave është 15,034,000 lekë, pra rreth 39 % e shumës totale të buxhetit. prej të cilit pjesën dërrmuese e kapin shpenzimet operative. dhe vetëm 8,989,000 lekë (23,3%) janë planifikuar për investime kryesisht për shkollat, ujesjellsat dhe kanalizimet e ujrave të zeza.

| **Figura 26. Burimet Kryesore në Buxhetin e Komunës (2003 – 2005)** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Të ardhurat e komunës (në mijë lekë)** | | | | | |
| **Nr** | **Viti** | **Transferta (granit) nga Buxheti i shtetit** | **Fonde të kushtëzuara nga Qeveria (ministritë)** | **Të ardhurat e vetë Komunës** | **Total** |
| 1 | 2003 | 4365 | 14365 | 12699 | 31429 |
| 2 | 2004 | 4365 | 18555 | 13249 | 36169 |
| 3 | 2005 | 4365 | 19132 | 15034 | 38531 |

| **Figura 27. Ku shkojnë të ardhurat (Shpenzimet e Komunës për vitin 2005)** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Funksionet | Shpenzimet dhe të dalat (në mijë lekë) | | | | |
| | Totali | Pagat | Kontributi i Sigurimeve Shoqërore | Shpenzime operative& mirëmbajtje | Investime |
| 1.Administrata e përgjithshme | 7965 | 4172 | 1167 | 1441 | 1185 |
| 2. Shërbimet Publike | 3424 | 453 | 156 | 2815 | |
| 3.Arsimi | 8490 | 6275 | 1858 | 357 | |
| 4.Shëndetësia | 1730 | 991 | 340 | 399 | |
| 5.Kultura | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6.Çeshtje sociale | 7831 | | | | 7831 |
| 7.Të tjera | 290 | | | 290 | |
| Nga këto:Fondi rezervë | 130 | 130 | | | |
| **TOTALI** | **29860** | **12021** | **3521** | **5302** | **8989** |

Në vitet në vazhdim komuna synon të rris të ardhurat kryesisht nga tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogel dhe nga disa tarifa shërbimi (zgjerim bazë jo rritje niveli).

## c. Pjesëmarrja Qytetare

Komuniteti i Xarrës është i interesuar që të marrë pjesë në proçesin e vendimmarrjes në komunën e tyre. Rreth 42.7% e familjeve të intervistuara shprehën interesin e tyre në këtë çështje. Megjithatë pjesëmarrja vazhdon të ngelet e ulët: 40% e banorëve të intervistuar shprehen se nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet të organizuar në të mirë të zhvillimit të komunës. E njëjta gjë mund të thuhet për pjesëmarrjen në takime të hapura të komunës. Takimet në komunitet gjithashtu nuk tërheqin interesin e shumë banorëve;megjithatë 42.2 % e tyre shprehën se nuk kanë marrë pjesë asnjëhere në këto takime ose kanë marrë pjesë 1 apo 2 herë në vit dhe 47% shprehen se nuk kanë qenë vullnetar në asnjë aktivitet të organizuar në grup.

| ***Objektivi 3: Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijshem dhe kanalizimit të ujrave të bardha dhe kanalizimit të ujrave të zeza*** | | |
|---|---|---|
| *Duke qenë një komunë me potenciale për zhvillimin e turizmit një nga prioritet e komunës së Xarrës është edhe përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm dhe atij të ujrave të zeza. Kjo do të realizohet nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të ujësjellësave dhe përmirësimit të atyre egzistues .* | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |
| Përmirësimi i sistemit të ujrave të bardha dhe të zeza për Fshatin Xarrë (Studim) | Vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit (Shiko Ankes në vazhdim)<br>Projekti teknik<br>Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh.<br>Prokurimi dhe ndërtimi | 2006 |
| Permiresimi i sistemit te ujrave te bardha dhe te zeza per Fshatin Vrine dhe Shendelli | Vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit<br>Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh.<br>Prokurimi dhe ndërtimi | 2007 - 2008 |
| Permiresimi i sistemit te ujrave te bardha dhe te zeza per Fshatin Mursi dhe Shkalle | Vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit<br>Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh.<br>Prokurimi dhe ndërtimi | 2008 - 2009 |
| Plotesimi me tub (140 160) dergimi dhe shperndarje te ujesjellsit te Mursise (2 km) | Ekziston vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit<br>Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh.<br>Prokurimi dhe ndërtimi | 2006 - 2007 |
| Ngritja e stacionit te pompimit dhe linjave shperndarese te fshatit Shkalle | Ekziston vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit<br>Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh.<br>Prokurimi dhe ndërtimi | 2006 - 2007 |

| ***Objektivi 4: Përmirësimi i shërbimit të pastrimit*** |
|---|
| *Sistemimi i territorit të komunës përfshin hartimin e planeve rregullues për çdo fshat të komunës, caktimi i vendeve të depozitimit të mbeturinave familjare si dhe tëë plehut organik në çdo fshat, si dhe azhornimin e rrjetit inxhinierik (rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza, të ujësjellësit, elektrik) për çdo fshat të komunës.* |

| *Projektet/Hapat e Veprimit* | *Hapat Konkrete/Shënim* | *Deri ne vitin:* |
|---|---|---|
| Vendosja e pikave kolektive të grumbullimit të mbeturinave nëpër lagje | - Ndërtimi nga komuna me fondet publike të pikave kolektive të grumbullimit të mbeturinave në bazë lagje, fshati.<br>- Përcaktime të sanksioneve/gjobave të ndryshme për dëmtime të mjedisit . Këto sanksione caktohen në bashkëpunim me ekspertë dhe miratohen nga Këshilli i komunës.<br>- Sensibilizimi i banorëve mbi domosdoshmërinë e këtij pastrimi<br>- Ndërgjegjësimi i komunitetit për hedhjen e mbetjeve inerte dhe të atyre organike në vende të veçanta. | 2006 - 2007 |
| Ndertimi i fushes se grumbullimit te mbeturinave dhe perpunimit | - Studimi dhe vlerësimi i gjendjes ( prefizibiliteti) i vendhedhjes së mbeturinave duke respektuar të gjitha kriteret urbanistike dhe përbërjen gjeologjike të tokës.<br>- Realizimi i projektit<br>- Kontaktime të herëpashershme me Zyrën Rajonale të Mbrojtjes së Mjedisit | 2007 |
| Studimi i mundësive për tërheqjen dhe grumbullimin e mbeturinave nga firmat private ose vet komuna | - Kontaktim me subjektet e liçensuara për nënshkrimin e kontratës së pastrimit të fshatrave.<br>- Bashkëpunim me Ministrinë e mjedisit për sigurimin e një kontenjeri për grumbullimin e mbeturinave në vendet e duhura. | 2007 |

***Objektivi 5: Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike***

*Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike përfshin përmirësimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nëpërmjet rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës dhe kabinave elektrike, përmirësimin e shërbimit të telekomunikacionit dhe atij postar si dhe vendosja e repititoreve të stacioneve televizive shqiptare.*

| *Projektet/Hapat e Veprimit* | *Hapat Konkrete/Shënim* | *Deri në vitin:* |
|---|---|---|
| Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike nëpërmjet rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës dhe kabinave elektrike | - Nëpërmjet takimeve të shpeshta komuna të nxisë Koorporatën e Energjisë Elektrike për përmirësimin e sistemit shpërndarës të energjisë elektrike, ndërtimin e kabinave të reja si dhe fuqizimin e tyre. | 2006 - 2007 |
| Ngritja e një nënstacioni me destinacion komunën Xarrë në fshatin Shkallë ose Butrint | - Studim për ngritjen e nënstacionit<br>- Identifikimi i investimeve/investitorëve për ndërtimin e nënstacionit | 2006 - 2007 |
| Përmirësimi i shërbimit të telefonisë fikse | - Nëpërmjet takimeve të shpeshta komuna do të nxisë Telekomin që të përshpejtojë instalimin dhe përdorimin e sistemeve radiorele që në afat të mesëm të mbulohen të gjitha fshatrat në komunë. | 2007 - 2008 |
| Vendosja e repititoreve të kanaleve televizive kombëtare shqiptare | - Nxitja dhe lehtësimi nëpërmjet takimeve periodike me përfaqësues të televizioneve kombëtare nga komuna apo sektori privat.<br>- Nxitja dhe lehtësimi përmes bisedimeve dhe të përkrahen operatorët privatë të zgjerojnë aktivitetin e komunës. | 2007 |

# Fusha Prioritare: Zhvillimi Social

Zhvillimi Social është përqëndruar kryesisht në drejtim të përmirësimit të jetës social kulturore, dhe të përkrahjes së shtresave në nevojë. Qendra e re kulturore i ka dhënë një nxitje të fortë gjallërimit të jetës kulturore dhe sociale në komunë. Banorët janë ndërgjegjësuar për vlerat historike dhe kulturore të Komunës. Qendrat shëndetësore ofrojnë shërbime të përmirësuara mjeksore duke përfshire ilaçe dhe pajisje të domosdoshme. Në zonat e largëta nga shkollat nxënësve janë krijuar kushte lehtësuese për arsimin e tyre si p.sh transporti, i cili ka sjellë rritjen e numrit të nxënësve të shkollave. Një element i rëndesishëm në zhvillimin social është dhe ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike të komunës.

**Objektivi Strategjik 1:** *Përmirësimi i jetës social kulturore të komunitetit*

Përmirësimi i jetës sociale ka sjellë uljen e migrimit të të rinjve nga komuna drejt qyteteve apo jashtë vendit. Pjesë e përmirësimit të jetës social kulturore është bërë ngritja e qendrës kulturore në fshatin Mursi, ngritja e ambjenteve çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët dhe pleqtë si dhe organizimi i grupeve artistike dhe i aktiviteteve kulturore.

**Objektivi Strategjik 5:** *Krijimi i Strukturave për identifikimin dhe trajtimin e shtresave në nevojë*

Nga prakikat e deritanishme nga komuna është bërë e mundur ardhja në ndihmë për familjet në nevojë dhe ata me aftësi të kufizuar. Ndonëse është bërë shumë pak synohet një studim i mirëfillt për trajtimin e këtyre familjeve dhe individëve për të bërë të mundur inkurajimin dhe rritjen e vëmendjes të shoqatave për ti përfshirë në programe mbështetje.

**Objektivi Strategjik3:** *Rritja dhe forcimi i sistemit shëndetësor*

Rritja dhe forcimi i shërbimit shëndetësor është shoqëruar me përmirësimin e infrastrukturës, ngritjen e objekteve shëndetësore dhe ambulancave të pajisura në fshatrat ku mungonin, duke mos lënë mënjanë dhe forcimin e masave për parandalimin e sëmundjeve infektive nëpërmjet imunizimit. Për të realizuar një shërbim të mirë dhe të kualifikur është konsideruar primare ngritja tekniko profesionale e personelit mjekësor nëpërmjet trajnimeve dhe specializimeve afatshkurtër.

**Objektivi Strategjik 4:** *Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor*

Objektet arsimore janë përmirësuar dhe lehtësuar duke rritur numrin e nxënësave në shkolla. Forcimi i dijes është përputhur me profilin e komunës, janë ngritur laboratorët për shkencat natyrore në shkollat e Xarrës dhe është ngritur gjimnazi për fëmijët e komunës Xarrë. Është bërë i detyrueshëm programi i gjuhës së huaj në shkollën e mesme dhe 9 vjeçare duke qenë se komuna është me perspektivë në zhvillimin e turizmit dhe thithjen e vizitorëve nga vendi dhe të huaj.

**Objektivi Strategjik 2:** *Ruajtja dhe promovimi trashëgimisë kulturore dhe historike*

Komuna Xarrë përmendet për pasurinë e saj me vlera kulturore dhe historike. Rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e veprave dhe objekteve kulturore e historike në ato fshatra të komunës ku ndodhen këto vepra dhe ruajtja e këtyre veprave është një nga objektivat kryesore në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe traditave brenda dhe jashtë vendit.

<table>
<tr><td colspan="2">FUSHA PRIORITARE: Zhvillimi Social</td><td rowspan="3">STRATEGJI DHE PLANE KOMBËTARE APO RAJONALE QË NDIKOJNË NË KËTË FUSHË PRIORITARE</td></tr>
<tr><td rowspan="5">Objektivat Strategjike</td><td>1.Përmirësimi i jetës social kulturore të komunitetit</td></tr>
<tr><td>2.Krijimi i Strukturave për identifikimin dhe trajtimin e shtresave në nevojë</td></tr>
<tr><td>3.Rritja dhe forcimi i sistemit shëndetësor</td><td>1. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social</td></tr>
<tr><td>4.Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor</td><td>2. Strategjia rajonale e Zhvillimit për Qarkun e Vlorës</td></tr>
<tr><td>5.Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike</td><td>3. Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin</td></tr>
</table>

| | **Hapat e Veprimit** | **Koha e Realizimit** |
|---|---|---|
| | **Përmirësimi i jetës social kulturore të komunitetit** | |
| 1. | 1. Ngritja e qendrës kulturore në Mursi (për komunën Xarrë) (është bërë studimi dhe është prioritet) | 2006 |
| | 2.Ngritja dhe pajisja e grupeve artistike me mjetet e nevojshme dhe funksionimi i tyre. | 2007 në vazhdimësi |
| | 3. Ngritja e ambjenteve çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët dhe pleqtë | 2008 |
| | 4. Organizimi i aktiviteteve kulturore në komunë | Në vazhdim |
| | **Krijimi i Strukturave për identifikimin dhe trajtimin e shtresave në nevojë** | |
| 2. | 1.Ngritja e një strukture të përbashkët nga administrata dhe mjeksia për evidentimin e familjeve dhe individëve në nevojë | 2006 dhe në vazhdim |
| | 2. Trajtimi i këtyre familjeve dhe individëve me asistencë sociale të plotë | Në vazhdim |
| | 3.Trajnime, kurse të ndryshme me këta banorë | Në vazhdim |
| | **Rritja dhe forcimi i sistemit shëndetësor** | |
| 3. | Ngritja tekniko profesionale e personelit mjekësor nëpërmjet trajnimeve/specializimeve afatshkurtër | Në vazhdim |
| | Forcimi i masave për parandalimin e sëmundjeve infektive nëpërmjet proçesit të imunizimit | Në vazhdim |
| | Furnizimi i ambulancave me pajisjet e domosdoshme të emergjencës si dhe medikamentet dhe materialet e mjekimit | Në vazhdim |
| | Ngritja e objekteve shëndetësore në fshatrat Mursi dhe Shendelli | 2006 - 2008 |
| | **Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor** | |
| 4. | Futja e leëdës së gjuhës së huaj në shkollën 8-vjeçare | 2006 në vazhdim |
| | Sigurimi i transportit të nxënësve për në shkolla (duke përfshirë shkollën e mesme që ndodhet në Ksamil dhe Konispol). | 2006 në vazhdim |
| | Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies | 2006, në vazhdim |
| | Ndërtimi i ambjenteve parashkollore (kopshti në Shkallë dhe Vrinë) | 2006 - 2007 |

| | | |
|---|---|---|
| | Ngritja / rikonstruksioni i institucioneve arsimore shkollore (ndërtimi i shkollës së mesme në Mursi) | 2010 |
| | Ngritja e laburatorëve për shkencat natyrore në shkollat 9 vjeçare | 2010 |
| | Futja e lëndës së informatikës në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme | 2009 |
| **Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike** | | |
| 5. | Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e këtyre veprave kulturore | Në vazhdimësi |
| | Promovimi i veprave kulturore dhe traditave brenda dhe jashtë vendit. | 2007 |
| | Rikonstruksioni i veprave kulturore historike në fshatin Xarrë dhe mirëmbajtja e këtyre veprave | 2008 |
| | Ngritja e muzeut historik të komunës në fshatin Mursi | 2007-2008 |

| Indikatorët Sasior | Aktuale 2005 | Synuar 2006 | Synuar 2008 | Synuar 2010 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i qendrave social kulturore | 0 | 1 | 1 | 1 |
| Numri i ambulancave | 3 | 4 | 4 | 5 |
| Numri i qendrave shëndetësore | 1 | 0 | 0 | 1 |
| Numri i shkollave të rikonstruktuara | 3 | 3 | 4 | 5 |
| Numri i kopshteve për fëmijë | 2 | 2 | 4 | 5 |
| Paisja e shkollave me laboratorë profesionale | 0 | 1 | 3 | 4 |

| Indikatorët Cilësor | Aktuale 2005 | Synuar 2006 | Synuar 2008 | Synuar 2010 |
|---|---|---|---|---|
| % e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me shërbimin e kopshteve dhe të çerdheve për fëmijë | 28.4 % | 30% | 50% | 50 % |
| % e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me gjendjen e shkollave në komunë | 63.4 % | 70% | 75% | 80% |
| % e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me jetën kulturore dhe artisitike në komunë | 13.8 % | 30% | 45% | 60% |
| % e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me shërbimin shëndetësor | 41.8% | 50% | 55% | 60% |

| ***Objektivi 1: Përmirësimi i jetës social kulturore ëe komunitetit*** | | |
|---|---|---|
| Përmirësimi i jetës sociale ka sjellë uljen e migrimit të të rinjve nga komuna drejt qyteteve apo jashtë vendit. Pjesë e përmirësimit të jetës social kulturore është bërë ngritja e qendrës kulturore në fshatin Mursi, ngritja e ambjenteve çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët dhe pleqtë si dhe organizimi i grupeve artistike dhe i aktiviteteve kulturore. | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |
| 1. Ngritja e qendrës kulturore në Mursi | Projektimi është përfunduar<br>Ky është një nga projektet prioritet për vitin 2006<br>Janë aprovuar fondet<br>Prokurimi dhe fillimi i ndërtimeve | 2006 |
| 2. Organizimi, funksionimi dhe paisja e grupeve artistike dhe organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike | Organizimi i këshillit të kulturës<br>Identifikimi i aftësive dhe individëve artistik tradicional<br>Formimi i grupeve artistike<br>Formulimi i programit të aktiviteteve dhe aprovimi në Këshillin e komunës | 2007<br>në vazhdim |
| 3. Ngritja e ambjenteve çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët dhe pleqtë | Ndertimi i një këndi lojrash për fëmijët<br>Ngritja e lulishteve me stola dhe ambjente çlodhëse | 2008 |
| 4. Organizimi i aktiviteteve kulturore në komunë | Identifikimi i grupeve artistike, shkollave, apo kengëtarëve të ndryshëm për pjesëmarrje në aktivitetet e zhvilluara nga komuna | Në vazhdim |

| ***Objektivi 2:*** **Krijimi i një strukture për identifikimin dhe trajtimin me përparësi të shtresave në nevojë dhe me aftësi të kufizuar** | | |
|---|---|---|
| *Me qëllim përfshirjen në shoqërinë e civilizuar, të familjeve dhe individeve në nevojë, nga ana e administratës së komunës dhe nga institucione të tjera duhet të merren masa konkrete dhe të hartohen programe për të bërë të mundur aktivizimin e tyre si të barabartë në shoqëri. Për familjet në nevojë do të shikohen të gjitha mundësitë e përfshirjes së tyre në të gjitha proçeset shoqërore.* | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |
| 1. Ngritja e një strukture të përbashkët nga administrata dhe mjeksia për evidentimin e familjeve dhe individëve në nevojë | Bashkpunim me përfaqësuesit e shërbimit parësor për ngritjen e një grupi evidentimi për familjet dhe individet në nevojë<br>Rakordim dhe bashkëveprim me Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike për sigurimin e karrocave për invalidët dhe individe të tjerë. | 2006 dhe në vazhdim |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Trajtimi i këtyre familjeve dhe individëve me asistencë sociale të plotë apo mundësi përmirësimi | Hapja e kurseve për rrobaqepsi për individet e mundshëm në bashkpunim me OJF në Sarandë<br>Caktimi i masës së ndihmës për familjet dhe individët e veçantë dhe miratimi në Këshill të komunës | Në vazhdim |
| 3. Trajnime, kurse të ndryshme me këta banorë | Trajnime të familjarëve për t'u ardhur në ndihmë individëve brenda familjes etj….. | Në vazhdim |

| | | |
|---|---|---|
| ***Objektivi3: Rritja dhe forcimi sistemit shëndetsor*** | | |
| Rritja dhe forcimi i shërbimit shëndetësor është shoqëruar me përmirësimin e infrastrukturës, ngritjen e objekteve shëndetësore dhe ambulancave të pajisura në fshatrat ku mungonin, duke mos lënë mënjanë dhe forcimin e masave për parandalimin e sëmundjeve infektive nëpërmjet imunizimit. Për të realizuar një shërbim të mirë dhe të kualifikur është konsideruar primare ngritja tekniko profesionale e personelit mjekësor nëpërmjet trajnimeve dhe specializimeve afatshkurtër. | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |
| Ngritja tekniko profesionale e personelit mjekësor nëpërmjet trajnimeve/specializimeve afatshkurtër | Identifikimi dhe punësimi i personelit profesional dhe sigurimi i trajnimit të vazhdueshëm<br>Lidhja me institucionet shëndetësore shkencore në nivel qarku, eksplorimi i mundësive për trainim dhe ofrimi i literaturës bashkëkohore | Në vazhdim |
| Forcimi i masave për parandalimin e sëmundjeve infektive nëpërmjet proçesit të imunizimit | Debistimi i sëmundshmërisë dhe studimi<br>Rritja e kulturës shëndetësore nëpërmjet ndërgjegjësimit të komunitetit<br>Vaksinimi i rregullt i popullsisë | Në vazhdim |
| Furnizimi i ambulancave me pajisjet e domosdoshme të emergjencës si dhe medikamentet dhe materialet e mjekimit | Identifikimi i nevojave për pajisjet e domosdoshme të emergejncës dhe medikamente<br>Krijimi i lehtësirave nga ana e komunës për ngritjen e një farmacie private në komunë | Në vazhdim |
| Ngritja e objekteve shëndetësore në fshatrat Mursi dhe Shendelli | Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave për rikonstruksion apo ndërtesa të reja shëndetësore.<br>Studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i kostos për ndërtimin, rikonstruksionin dhe paisjen e objekteve shëndetësore<br>Duke filluar nga viti 2006 përfshirja në buxhetin e komunës të rikonstruksionit të objekteve ekzistuese si dhe përfshirja e objekteve të reja shëndetësore për ndërtim.<br>Identifikimi i burimeve të tjera të financimit për bashkëfinancimin e ndërtimit, rikonstruksionit dhe paisjes së objekteve shëndetësore | 2006 - 2008 |

| | | |
|---|---|---|
| ***Objektivi 4: Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor*** | | |
| Objektet arsimore janë përmirësuar dhe lehtësuar dhe rritur numrin e nxënësave në shkolla. Forcimi i dijes është përputhur me profilin e komunës, janë ngritur laboratorët për shkencat natyrore në një nga shkollat e komunës, si dhe është bërë i detyrueshëm programi i gjuhës së huaj në shkollën e mesme dhe 9 vjeçare duke qenë se komuna është me perspektive në zhvillimin e turizmit dhe thithjen e vizitorëve nga vendi dhe të huaj. Transporti i përmirësuar siguron shkollimin e nxënësve nga zonat e largëta duke ulur ndjeshëm numrin e fëmijëve që braktisin shkollën. | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |

| | | |
|---|---|---|
| Futja e lëndës së gjuhës së huaj në shkollën 9-vjeçare dhe gjimnaz | - Krijimi i mundësive nëpërmjet drejtorisë arsimore për përfshirjen e mësuesve të gjuhës së huaj<br>- Futja e gjuhës së huaj edhe në aktivitetet jashtë shkollore<br>- Tërheqja e vullnetarëve të Peace Corps për të asistuar në zhvillimin e lëndës së gjuhës së huaj | 2006 në vazhdim |
| Sigurimi i transportit të nxënësve për në shkolla (duke përfshirë shkollën e mesme që ndodhet në Ksamil dhe Konispol). | - Kontraktimi i subjekteve private nga komuna për manaxhimin e transportit të nxënësve, duke inkurajuar financimin e pjesshëm nga familjet. | 2006 në vazhdim |
| Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies | - Trajnimi/kualifikimi i arsimtarëve<br>- Vendosja e kritereve dhe punësimi i mësuesve sipas profilit dhe arsimimit<br>- Forcimi i lidhjeve të komitetit të prindërve me mësuesit | 2006, në vazhdim |
| Ndërtimi i ambjenteve parashkollore (kopshti në Shkallë dhe Vrinë) | - Vlerësimi, studimi i fizibilitetit dhe përfshirja në buxhetin e komunës për financim të drejtpërdrejte dhe bashkëfinancim të rikonstruksionit të objekteve ekzistuese si dhe e objekteve të reja | 2006 - 2007 |
| Ngritja / rikonstruksioni i institucioneve arsimore shkollore (ndërtimi i shkollës së mesme në Mursi) | - Rikonstruksioni i objekteve shkollore<br>- Vlerësimi, studimi i fizibilitetit dhe përfshirja në buxhetin e komunës për financim të drejtpërdrejtë dhe bashkëfinancim të rikonstruksionit të objekteve ekzistuese si dhe e objekteve të reja përfshirë gjmnazin në Mursi. | 2010 |
| Ngritja e laboratorëve për shkencat natyrore në shkollat 9 vjeçare | - Vlerësimi, studimi i fizibilitetit, planifikimi dhe caktimi i hapësirave të mundshme për ngritjen e laboratorëve në një prej shkollave të komunës.<br>- Kontaktimi me Ministrinë e Arsimit, Drejtorinë Arsimore apo donatorë të ndryshëm për mundësi financimi të ndërtimit dhe paisjes së laboratorëve shkollore. | 2010 |
| Futja e lëndës së informatikës në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme | - Krijimi i mundësive nëpërmjet drejtorisë arsimore për përfshirjen e mësuesve të informatikës<br>- Futja e mësimit të kompjuterit edhe në aktivitetet jashtë shkollore (qendra kulturore)<br>- Identifikimi i individëve për dhënien e mësimit të informatikës | 2009 |

| ***Objektivi 2: Ruajtja dhe promovimi i trashëgimise kulturore dhe historike*** | | |
|---|---|---|
| Komuna Xarrë përmendet për pasurinë e saj me vlera kulturore dhe historike. Rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e veprave dhe objekteve kulturore e historike në ato fshatra të komunës ku ndodhen këto vepra dhe ruajtja e këtyre veprave është një nga objektivat kryesore në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe traditave brenda dhe jashtë vendit. | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |
| Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e këtyre veprave kulturore | - Përgatitja e fletëpalosjeve, informacionit për ekzistencën e veprave të kulturës në komunë<br>- Shpërndarja e këtyre materialeve në komunitet<br>- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme me qëllim promovimin e këtyre vlerave kulturore dhe historike | Në vazhdimësi |

| | | |
|---|---|---|
| Promovimi i veprave kulturore dhe traditave brenda dhe jashtë vendit. | - Hartimi i guidës turistike dhe të promovimit të vlerave kulturore historike të Komunës<br>- Realizimi i një spoti televiziv dhe fushata e ndërgjegjësimit dhe informimit kombëtar nëpërmjet medias | 2007 |
| Rikonstruksioni i veprave kulturore historike në fshatin Xarrë dhe mirëmbajtja e këtyre veprave | - Kontakti dhe zhvillimi i një plani të përbashket me Institutin e Monumenteve të Kulturës<br>- Planifikimi dhe bashkëfinancimi për rikonstruksionin | 2008 |
| Ngritja e muzeut historik të komunës në fshatin Mursi | - Kontakti dhe zhvillimi i një plani të përbashket me Institutin e Monumenteve të Kulturës<br>- Planifikimi dhe bashkëfinancimi i ndërtimit të muzeut | 2007-2008 |

# Fusha Prioritare: QEVERISJA E MIRE

*Qeverisja e mirë në komunën Xarrë është bërë promotore e zhvillimit ekonomik dhe social. Strukturat vendim-marrëse dhe ekzekutive të komunës janë të hapura për një vendim-marrje me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit. Zbatimi i vendimeve është mbështetur në parimin e decentralizmit dhe përcaktimit rigoroz të përgjegjësive. Banorët e komunës gjejnë informacionin e nevojshëm, ndërsa iniciativat për biznes janë mbështetur dhe lehtësuar nga administrata dhe vendim-marrësit. Mbledhjet e hapura të këshillit, anketimet, publikimi i informacionit janë bërë mjete komunikimi gjerësisht të përdorshme ndërmjet komunës dhe banorëve të saj. Personeli administrativ është i qëndrueshëm dhe me kapacitete në rritje në përgjigje të dinamikës së zhvillmit dhe të nevojave të komunitetit.*

***Objektivi Strategjik1:*** *Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës,këshillit të komunës dhe kryetarëve të fshatrave*

Një nga elementet e mirë-qeverisjes ka qenë gjithmonë decentralizimi i vendim-marrjes dhe ekzekutimit, përcaktimi dhe ndarja e përgjegjësive të organeve apo individeve të ndryshëm brenda strukturave të qeverisjes vendore përmes hartimit dhe përdorimit të një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë- këshilli – kryepleqësi. Kjo është shoqëruar dhe me realizimin e takimeve/tavolinave të hapura për kryetarët e fshatrave dhe banorët e komunës me qëllim informimin, vlerësimin e nevojave dhe prirotizimin e veprimeve dhe investimet e realizuara apo ato të planifikuara.

***Objektivi Strategjik2:*** *Rritja e transparencës*

Transparenca me komunitetin është parim themelor i aktivitetit vendim-marrës dhe ekzekutiv të komunës e cila ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për marrjen dhe dhënien e informacionit nëpërmjet publikimit në stenda apo nëpërmjet fletëpalosjeve lidhur me ndyshimet në strukturën e komunës, buxhetin, taksat dhe tarifat, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj. Një person në administratën e komunës është ngarkuar posaçërisht për shpërndarjen e informacionit.

***Objektivi Strategjik 3:*** *Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje*

Rritja e transparencës dhe komunikimit është zhvilluar njëkohësisht edhe në kahun e marrjes së informacionit nga komuniteti. Marrja e mendimit nga komuniteti nëpërmjet takimeve të hapura në fshatra të kombinuara me anketimin masiv janë bërë mjete të përdorimit të zakonshëm për indetifikimin e nevojave dhe të prioriteve në kuadrin e hartimit të buxhetit si dhe rishikimin e planeve afat-gjata të zhvillimit.

***Objektivi Strategjik 4:*** *Përmirësimi i kapaciteteve për stafin dhe këshilltarët*

Përmirësimi i komunikimit me të gjitha nivelet, rritja e transparencës, thithja e opinionit qytetar kanë kërkuar një staf dhe këshill komune të përgatitur si dhe mjetet e nevojshme për t'u realizuar. Për këtë qëllim, trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon, trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese kanë qenë elementet kryesor për ngritjen e kapaciteteve. Funksionimi dhe kompletimi i arshivës me bazën e nevojshme materiale si dhe paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera janë bërë elementet në aktivitetin e vazhdueshëm të komunës.

<table>
<tr><td colspan="2">FUSHA PRIORITARE: Për një qeverisje më të mirë</td><td colspan="2" rowspan="2">STRATEGJI DHE PLANE KOMBËTARE APO RAJONALE QË NDIKOJNË NË KËTË FUSHË PRIORITARE</td></tr>
<tr><td rowspan="4">OBJEKTIVAT STRATEGJIKE</td><td>1. Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës, këshillit të komunës dhe kryepleqve</td></tr>
<tr><td>2. Rritja e transparencës</td><td colspan="2">1. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social</td></tr>
<tr><td>3. Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje</td><td colspan="2">2. Strategjia rajonale e Zhvillimit për Qarkun e Vlorës</td></tr>
<tr><td>4. Përmirësimi i kapaciteteve për stafin dhe këshilltarët</td><td colspan="2">3. Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin</td></tr>
<tr><td colspan="3">Hapat e veprimit</td><td>Koha e realizimit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës, këshillit të komunës dhe kryepleqve</td></tr>
<tr><td rowspan="4">1.</td><td colspan="2">Përgatitja, aprovimi dhe vënia në përdorim e një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë-këshilli – kryepleqësi.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Realizimi periodik i takimeve/tavolinave të rrumbullakta me qëllim informimin e kryetarëve të fshatrave, këshillit të komunës dhe kryetarit për punën e kryer, investimet e realizuara, ato të planifikuara apo aktivitete të ndryshme.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Realizimi i takimeve/tavolinave të rrumbullakta me qëllim marrjen e informacionit nga kryepleqtë për nevojat e fshatrave.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Thirrja e kryetarëve të fshatrave dhe banorëve të spikatur në mbledhjet e këshillit të komunës dhe realizimi i seancave dëgjimore paraprirëse të mbledhjeve të këshillit me qëllim vendim-marrje të rëndësishme.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rritja e transparencës</td></tr>
<tr><td rowspan="5">2.</td><td colspan="2">Ngritja e stendës së informacionit në komunë</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Caktimi i një personi në stafin e komunës për të ofruar informacion tek komuniteti në zyrat e komunës.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Afishimi i informacionit të nevojshëm (struktura e komunës, buxheti, taksat dhe tarifat, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj..) në stendën e komunës.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i mbledhjeve të hapura/seancave dëgjimore për komunitetin gjatë miratimit të proçeseve/aktiviteteve të rëndësishme që ndikojnë jetën e komunitetit.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nxitja e marrdhënieve me median lokale/kombëtare, të shkruar dhe vizive.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje</td></tr>
<tr><td rowspan="4">3.</td><td colspan="2">Marrja e mendimit qytetar dhe e komunitetit nëpërmjet takimeve të hapura në fshatra me pjesëmarrjen e kryetarëve të fshtrave, kryetarit të komunës dhe antarëve të këshillit</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përdorimi i mjeteve të ndryshme për të marrë opinionin e qytetarëve gjatë hartimit të buxhetit dhe caktimit të prioriteteve.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Organizimi i mbledhjeve të hapura, anketimeve për marrjen e vendimeve të rëndësishme që ndikojnë në jetën e komunitetit</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Përgatitja e herëpasherëshme e fletepalosjeve për informimin e komunitetit.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Përmirësimi i kapaciteteve për stafin dhe këshilltarët</td></tr>
<tr><td rowspan="3">4.</td><td colspan="2">Përgatitja dhe aprovimi i një rregulloreje të brendëshme për funksionimin e ekzekutivit dhe ndarjen e përgjegjësive në mënyrë që të rritet efiçenca dhe efektiviteti i zyrtarëve të administratës</td><td>2007, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese.</td><td>2006, në vazhdim</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | Paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera. | 2007, në vazhdim |

| O.S | Indikatorët Sasiorë | Aktuale 2005 | I synuar 2006 | I synuar 2008 | I synuar 2010 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 1. Numri i takimeve të përbashkëta komunë-anëtarë këshilli-kryepleq | 2 | 4 | 6 | 12 |
| | 2. Përqindja e problemeve të parashtruara nga kryepleqtë dhe të zgjidhura pozitivisht | 40% | 60 % | 85 % | 95 % |
| 2. | 1. Frekuenca e rinovimit të përmbajtjes së stendës së informacionit. | 0 muaj | 4 herë në vit | 10 herë në vit | 12 herë në vit |
| | 2. Numri i mbledhjeve të hapura me komunitetin për miratimin e proçeseve që ndikojnë në jetën e komunitetit. | 2 | 4 (për buxhet dhe raportime) | 6 (buxhetin dhe për raportime) | 6 (buxhetin dhe raportime) |
| | 3. Numri i informacionit për zhvillimet në komunë që transmetojnë mediat lokale | 0 | 2 (1 kronikë e zgjeruar) | 4 (2 kronika të zgjeruara) | 6 (2 kronika të zgjeruara) |
| 3. | 3.Numri i anketimeve të komunitetit me subjekt vendim marrjet e rëndësishme. | 1 | 1 | 2 | 2 |
| | 4. Numri i fletëpalosjeve informuese për komunitetin nga administrata vendore. | 300 | 500 (1 herë në vit) | 1200 (2 herë në vit) | 1200 (2 herë në vit) |
| 4. | 1. Numri i trajnimeve të organizuar me stafin e komunës apo pjesë të veçanta të tij. | 0 | 2 | 6 | 12 |
| | 2. Numri i trajnimeve të këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. | 0 | 2 | 5 | 10 |
| | 3.Numri i kompjuterave në komunë. | 1 | 4 | 8 | 10 |

| Indikatorët Cilësor | Aktuale 2005 | I synuar 2006 | I synuar 2008 | I synuar 2010 |
|---|---|---|---|---|
| 1. % e banorëve të cilët mendojnë se në harkun kohor prej 5 vjetësh sasia e infromacionit nga komuna është rritur | 59.6% | | | >70% |
| 2. % e banorëve të cilët mendojnë se intesiteti i informacionit me mjetet e komunikues është rritur | 12.9 %[1] | 25% | 40% | >50% |
| 3. % e banorëve që pohojnë pjesëmarrjen e tyre në proçeset vendim marrëse për hartimin e buxhetit,caktimin e investimeve dhe në marrjen e vendimeve me rëndësi për komunitetin. | 41.5 % | 47 % | 55% | >60 % |
| 4. % e banorëve të cilët mendojnë se janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me kohën e kryerjes së shërbimeve nga administrata e komunës | 45.7% | 50% | 70% | >70 % |
| 5. % e banorëve të cilët janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me aftësinë e komunës për tu përgjigjur dhe zgjidhur problemet e tyre | 40.9% | 47% | 55% | >60 % |

[1] Këtu përfshihen mjete të tilla si: gazeta lokale, qendra e informimit në komunë, stendat (këndet) e njoftimit, mbledhjet e këshillit, kontakti me zyrtarë të komunës

| ***Objektivi1: Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës,këshillit të komunës dhe kryepleqve*** | | |
|---|---|---|
| Një nga elementet e mirë-qeverisjes ka qenë gjithmonë decentralizimi i vendim-marrjes dhe ekzekutimit, përcaktimi dhe ndarja e përgjegjësive të organeve apo individeve të ndryshëm brenda strukturave të qeverisjes vendore përmes hartimit dhe përdorimit të një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë-këshilli – kryepleqësi. Kjo është shoqëruar dhe me realizimin e takimeve/tavolinave të hapura për kryetarët e fshatrave dhe banorët e komunës me qëllim informimin, vlerësimin e nevojave dhe prirotizimin e veprimeve dhe investimet e realizuara apo ato të planifikuara | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |
| 1. Përgatitja, aprovimi dhe vënia në përdorim e një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë- keshilli – kryepleqësi si dhe konsolidohet pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje. | Kontakti me njësi të tjera vendore të cilat kanë adaptuar një kod etike,<br>Adaptimi i kodit të etikes për kushtet e komunës<br>Aprovimi dhe zbatimi i kodit të etikës | ***2006 në vazhdim*** |
| 2. Realizimi periodik i takimeve/tavolinave të rrumbullakta me qëllim informimin e kryetarëve të fshatrave, këshillit të komunës dhe kryetarit për punën e kryer, investimet e realizuara, ato të planifikuara apo aktivitete të ndryshme. | Vendimi i Këshillit të Komunës për thirrjen e mbledhejve të hapura të Keshillit | ***2006 në vazhdim*** |
| 3. Realizimi i takimeve/tavolinave të rrumbullakta me qëllim marrjen e informacionit nga kryepleqtë për nevojat e fshatrave. | | |
| 4. Thirrja e kryetarëve të fshatrave dhe banorëve të spikatur në mbledhjet e këshillit të komunës dhe realizimi i seancave dëgjimore paraprirëse të mbledhjeve të këshillit me qëllim vendim-marrje të rëndësishme. | | |

| ***Objektivi 2: Rritja e Transparences*** | | |
|---|---|---|
| Transparenca me komunitetin është parim themelor i aktivitetit vendim-marrës dhe ekzekutiv të komunës e cila ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për marrjen dhe dhënien e informacionit nëpërmjet publikimit në stenda apo nëpërmjet fletëpalosjeve lidhur me ndyshimet në strukturën e komunës, buxhetin, taksat dhe tarifat, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj. Një person në administratën e komunës është ngarkuar posaçërisht për shpërndarjen e informacionit | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin:*** |
| 1. Ngritja e stendës së informacionit në komunë | Vendimi i Këshillit të Komunës për thirrjen e mbledhejve të hapura të Këshillit | ***2006 në*** |
| 2. Caktimi i një personi në stafin e komunës për të ofruar informacion tek komuniteti në zyrat e komunës. | | |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Afishimi i informacionit të nevojshëm (struktura e komunës, buxheti, taksat dhe tarifat, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj..) në stendën e komunës. | | ***vazhdim*** |
| 4.Organizimi i mbledhjeve të hapura/seancave dëgjimore për komunitetin gjatë miratimit të proçeseve/aktiviteteve të rëndësishme që ndikojnë jetën e komunitetit. | | |
| 5. Nxitja e marrdhënieve me median lokale/kombëtare, të shkruar dhe vizive. | *Takimi me autoritetet e medias me bazë në Sarandë*<br>*Parashtrimi i një kërkese për të kërkuar pasqyrimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve që zhvillohen në komunë*<br>*Arritja e një marrëveshje me televizionin publik me bazë në Sarandë* | ***2006 në vazhdim*** |

| ***Objektivi3: Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje*** | | |
|---|---|---|
| Rritja e transparencës dhe komunikimit është zhvilluar njëkohësisht edhe në kahun e marrjes së informacionit nga komuniteti. Marrja e mendimit nga komuniteti nëpërmjet takimeve të hapura në fshatra të kombinuara me anketimin masiv janë bërë mjete të përdorimit të zakonshëm për indetifikimin e nevojave dhe të prioriteve në kuadrin e hartimit të buxhetit si dhe rishikimin e planeve afat-gjata të zhvillimit. | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri neëvitin*** |
| 1. Marrja e mendimit qytetar dhe e komunitetit nëpërmjet takimeve të hapura në fshatra me pjesëmarrjen e kryetarëve të fshatrave, kryetarit të komunës dhe anëtarëve të këshillt | *Pjesëmarrja e kryetareve të fshatrave dhe banorëve të spikatur në mbledhjet mujore të këshillit të komunës*<br>*Organizimi i mbledhjeve të hapura për diskutimin dhe aprovimin e buxhetit vjetor*<br>*Anketimi vjetor për vlerësimin e nevojave* | ***2006*** |
| 2. Organizimi i mbledhjeve të hapura, anketimeve për marrjen e vendimeve të rëndësishme që ndikojnë në jetën e komunitetit | | |
| 3. Përgatitja e herëpasherëshme e fletëpalosjeve për informimin e komunitetit. | | |

| ***Objektiv4: Përmirësimi i kapaciteteve për stafin dhe këshilltarët*** | | |
|---|---|---|
| Përmirësimi i komunikimit me të gjitha nivelet, rritja e transparencës, thithja e opinionit qytetar kanë kërkuar një staf dhe këshill komune të përgatitur si dhe mjete te nevojshme për t'u realizuar. Për këtë qëllim, trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon, trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese kanë qenë elementet kryesor për ngritjen e kapaciteteve. Funksionimi dhe kompletimi i arshivës me bazën e nevojshme materiale si dhe paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera janë bërë elementet në aktivitetin e vazhdueshëm të komunës | | |
| ***Projektet/Hapat e Veprimit*** | ***Hapat Konkrete/Shënim*** | ***Deri në vitin*** |

| | | |
|---|---|---|
| 1. Përgatitja dhe aprovimi i një rregullorejë të brendëshme për funksionimin e ekzekutivit dhe ndarjen e përgjegjësive në mënyrë që të rritet efiçenca dhe efektiviteti i zyrtarëve të administratës | *Kontakti me projektet e asistencës për Pushtetin Vendor me bazë në Qarkun e Vlorës*<br>*Angazhimi i një grupi pune për formulimin e rregullores*<br>*Aprovimi në Këshill* | 2007, në vazhdim |
| 2. Trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon | *Parashtrimi i kërkesës për trainim në Këshillin dhe strukturat e caktuara në administratën e qarkut në Vlorë*<br>*Regjistrimi dhe ndjekja e kurseve të trainimit që organizohen në qarkun e Vlorës nga administrata e qarkut dhe projektet e asistencës* | 2006, në vazhdim |
| 3. Trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese. | | |
| 4. Paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera. | *Eksplorimi i mundësive për financim nga buxheti i komunës*<br>*Kontakti me projekte të asistencës dhe identifikimi i burimeve të mundshme të financimit* | 2007, në vazhdim |